

# Les Bibliothèques de la Ville de Lausanne

## Informations pratiques

Bibliotekat e Qytetit të Lozanës  
Informacione praktike

(albanais)



Ville de Lausanne

Les bibliothèques

## Bibliotekat e Qytetit të Lozanës

### **Informacionepraktike**

Ky dokument shpjegon rregulloren e bibliotekave. Ai ju shpjegon si ti përdorni me lehtësi bibliotekat e Qytetit të Lozanës.

Çfarë mund të bëni në biblioteka ? .....	2
Informacione për përdorimin e bibliotekës.....	5
Siti Internet i bibliotekave dhe oferta numerike.....	8
“Lire à Lausanne” (Të lexosh në Lozanë).....	9
Adresat dhe oraret.....	10
Tarifat.....	12
Siti i bibliotekave .....	15

## Çfarë mund të bëni në biblioteka ?

### Të zbuloni dokumente

Në Bibliotekat e Qytetit të Lozanës, ka më se 220'000 dokumente, për të vegjël e të rritur, qysh nga lindja.

Për të gjetur dokumentet, ju mundeni :

- ti kërkoni ato lirshëm, drejtpërdrejt në bibliotekat e rritit
- ti rezervoni në linjë
- ti kërkoni në sportel

Ka, për shembull :

- romane
- banda të vizatuara dhe manga
- gazeta dhe revista
- libra audio
- filma dhe seri TV
- lojëra video
- libra në gjuhë të ndryshme
- dokumente informuese në të gjitha fushat
- një ofertë kulturore për tu huazuar (bileta për muzetë lozanezë për shembull)
- aparate lexues me libra numerikë të para-ngarkuar

## Të punoni në qetësi

Ju mund të vini të punoni, studioni e lexoni në qetësi në sallat e leximit.

Ju mund të lexoni ulur në kolltukë të rehatshëm.

## Të shikoni filma dhe të dëgjoni libra audio

Në biblioteka, ju mund të shikoni një film apo të dëgjoni një libër audio. Ne ju huazojmë lexues Blu-ray/DVD/CD dore me kufje audio.

Ju mund të ndiqni gjithashtu një kurs gjuhe në sitin tonë.

Kërkojeni materialin në sportel !

## Lundroni në Internet

Hyrja në Wi-Fi-në e Qytetit të Lozanës është falas.

Ju mund të lundroni në Internet duke huazuar një tabletë të prekshme.

Nëse keni nevojë të përdorni programe zyre dhe të shtypni një dokument, mund të përdorni një kompjuter.

## Të huazoni sende

### **Keni harruar kufjet ?**

S'ka problem, ju huazojmë ne kufje audio.

### **Celulari juaj ka nevojë të ngarkohet ?**

Ne ju vëmë në dispozicion ngarkues.

### **Është shkruar me germa tepër të vogla. Nuk mund të lexoni ?**

Ka shumë libra me germa të mëdha në dispozicion.

Mund të huazoni edhe një lupë te pritja.

Kur huazoni një tabletë, në tabletë ka një lupë numerike. Kjo lupë ju lejon edhe ti modifikoni kontrastet në tekst madje edhe ta dëgjoni një tekst. Ne mund t'ju shpjegojmë se si të bëni për ta përdorur.

### **Nuk keni stilolaps me vete ?**

Mos u shqetësoni, ne ju huazojmë qeska me stilolapsa, lapsa, goma vizore dhe gërshërë.

Ju mund ta përdorni këtë material brenda bibliotekave.

Për më shumë informacione, mos nguroni tu drejtoheni punonjësve të bibliotekave në sportele !

## Informacione për përdorimin e bibliotekës

Për ta përdorur mirë një bibliotekë, dhe për të huazuar dokumente, ka shumë gjëra për të ditur. Këto quhen **kushtet e përdorimit**.

Një dokument, është për shembull një libër, një libër audio, një DVD, një lojë video apo një revistë.

### Sa dokumente mund të huazoni ?

Nga tetori në maj, ju mund të huazoni 20 dokumente e shumta.

Gjatë verës (nga qershori në shtator), ju mund të huazoni 30 dokumente e shumta.

### Për sa kohë ?

Ju mund të huazoni dokumente për 28 ditë.

Ju mund ta zgjasni e shumta 1 herë afatin e huazimit tuaj.

### Dokumentet duhet ti ktheni ?

Dokumentet duhet ti ktheni në një nga bibliotekat e rrjetit gjatë orëve të hapjes.

Dokumentet duhet ti ktheni e shumta ditën e mbarimit të afatit për të shmangur shpenzimet e vonesës.

Në dispozicion janë kutitë e kthimit, kur bibliotekat janë të mbyllura.

### Është me rëndësi lidhur me kutitë e kthimit !

Dokumentet duhet ti ktheni një ditë para mbarimit të afatit, për të shmangur shpenzimet e vonesës.

Nganjëherë, kutitë janë plot.

## Si veprohet ?

Për tu regjistruar dhe për të huazuar dokumente, është falas.

## Mund të regjistroheni në bibliotekë

Duke paraqitur letërnjoftimin tuaj të vlefshëm në Zvicër (letërnjoftim zviceran, pasaportë zvicerane apo leje qëndrimi).

Karta është për një njeri të vetëm.

Biblioteka kërkon **respektimin e kushteve të përdorimit**.

Për shembull :

- qysh ditën e parë të vonesës, ju duhet të paguani shpenzime,
- nëse e humbisni apo e dëmtoni një dokument, duhet të paguani për zëvendësimin apo riparimin e tij
- nëse shikoni se një dokument është i dëmtuar, **para** se ta huazoni, duhet të na sinjalizoni. Po që se nuk e bëni këtë, duhet të paguani për riparimin e tij.

Tarifat tona do ti gjeni në faqet 12 deri në 14.

## Për ta rezervuar një dokument ?

Ju mund të rezervoni një dokument tashmë të huazuar nga një njeri tjetër. Është falas.

Për të rezervuar, ju mund :

- të shkoni në sitin e bibliotekës : [bavl.lausanne.ch](http://bavl.lausanne.ch)
- të drejtoheni në sportel

Për të vënë mënjanë një dokument që është në raft, ju mund të drejtoheni në sportelin e bibliotekës suaj.

## Për të zgjatur afatin e një dokumenti që e keni huazuar

Ju mund ta zgjasni afatin e huazimit 1 herë e shumta. Për 28 ditë të tjera.

Për ta zgjatur, në se një dokument nuk është rezervuar nga një njeri tjetër, ju mundeni :

- të thërrisni me telefon : në 021 315 69 15
- të kërkoni me e-mail : [bibliotheques@lausanne.ch](mailto:bibliotheques@lausanne.ch)
- ta bëni zgjatjen gjysh nga llogaria në linjë në sitin tonë Internet : [bavl.lausanne.ch](http://bavl.lausanne.ch)
- ta bëni zgjatjen qysh nga pikat e huamarrjes në bibliotekë
- të pyesni në sportel

## Lidhje për te kushtet e përdorimit

Për rregulloren :

[www.lausanne.ch/bibliotheques-reglement](http://www.lausanne.ch/bibliotheques-reglement)

Për tarifat :

[www.lausanne.ch/bibliotheques-tarifs](http://www.lausanne.ch/bibliotheques-tarifs)

## Siti Internet i bibliotekave dhe oferta numerike

### **Siti internet i bibliotekave**

bavl.lausanne.ch

Çfarë informacionesh mund të gjej në sitin e bibliotekave ?

Ju gjeni :

- katalogun tonë
- adresat dhe oraret e bibliotekave të rrjetit,
- të gjitha komunikimet e rëndësishme

Në sitin [bavl.lausanne.ch](http://bavl.lausanne.ch) ju mund të :

- administroni llogarinë tuaj nga banesa juaj
- verifikoni huazimet tuaja
- rezervoni dokumentet tashmë të huazuara
- gjeni ide leximi
- keni qasje në ofertën tonë numerike
- lexoni gazeta dhe revista në gjuhë të ndryshme
- gjeni mundësi për tu formuar në fusha të ndryshme
- huazoni libra elektronike dhe libra audio elektronike

## “Lire à Lausanne” (Të lexosh në Lozanë)

### **Programi i veprimtarive kulturore**

“Lire à Lausanne” është një program veprimtarish për të vegjlit e të mëdhenjtë. Këto veprimtari propozohen nga Biblioteka e Qytetit të Lozanës.

Programi “Lire à Lausanne” ju propozon veprimtari përgjatë tërë vitit.

Gjithçka është falas !

Ju mund ta kërkonit programin kulturor “Lire à Lausanne” në bibliotekë. Ose ti merrni informacionet çdo muaj drejtpërdrejt me e-mail !

Regjistrohuni në newsletter-ën tonë nga llogaria tuaj në linjë ose në sportelin e bibliotekës !




# Plan



## **Bibliobus**

Plusieurs stations  
dans Lausanne

- **1**  
**Bibliothèque Chailly**
- **2**  
**Bibliothèque Chauderon**
- **3**  
**Bibliothèque Bellevaux:  
publique et scolaire**
- **4**  
**Bibliothèque Jeunesse**
- **5**  
**Bibliothèque La Sallaz**
- **6**  
**Bibliothèque Montriond**





## Adresat dhe oraret

### Bibliobusi

Shumë stacione brenda në Lozanë

079 622 63 74

Oraret dhe stacionet : [www.lausanne.ch/bibliobus](http://www.lausanne.ch/bibliobus)

### Biblioteka Chailly

Avenue de la Vallonnette 12

1012 Lausanne

021 315 69 70

e hënë, e martë, e premte : 13.30 – 18.30

e mërkurë: 10.00 – 13.00, 13.30 – 19.00

### Biblioteka Chauderon

Place Chauderon 11

1003 Lausanne

021 315 69 15

e hënë, e martë, e mërkurë, e enjte, e premte : 12.00 – 19.00

e shtunë : 11.00 – 17.00

### Biblioteka Bellevaux : publike dhe shkollore

Chemin d'Entre-Bois 10

1018 Lausanne

021 315 69 18

e hënë, e martë, e enjte, e premte : 14.00 – 19.00

e mërkurë: 12.00 – 19.00

### Biblioteka Jeunesse

Avenue d'Echallens 2A

1004 Lausanne

021 315 69 17

e hënë, e premte: 15.00 – 18.00

e hënë, e mërkurë, e enjte : 10.00 – 12.00, 15.00 – 18.00

e shtunë : 10.00 – 16.00

### Biblioteka La Sallaz

Place de la Sallaz 4

1010 Lausanne

021 315 69 90

e hënë, e martë, e enjte, e premte : 14.00 – 19.00

e mërkurë : 12.00 – 19.00

### Biblioteka Montriond

Avenue F.-de-la-Harpe 2bis

1007 Lausanne

021 315 69 80

e hënë, e martë, e premte : 14.00 – 19.00

mercredi, jeudi : 10.00 – 12.00, 14.00 – 19.00

## Tarifat

### Pajtimi si vizitor

Ju jeni në Zvicër për pak kohë ?  
E doni ta përdorni bibliotekën?  
Atëherë, ju mund të bëni një **pajtim si vizitor**.

Pajtimi është i vlefshëm 3 muaj. Ju mund ta ripërsërisni 1 herë.

për të bërë pajtimin, personat nga 18 vjeç e sipër duhet të paguajnë një **garanci**. Bëhet fjalë për depozitimin e një shume të hollash.

Në fund të pajtimit, nëse gjithçka është në rregull (për shembull nuk ka vonesë), këto të holla ju kthehen.

Garancia nga 18 vjeç e sipër Frz 100.-

### Shpenzime për vonesë

Huazimi i një apo disa dokumenteve, është falas.

Pajtimi për të Rriturit (nga 18 vjeç e sipër) : nëse i ktheni dokumentet me vonesë, ju duhet të paguani :

javën e 1rë të vonesës : kujtesë me shkrim, Frz 4.- nga 18 vjeç e sipër.

javën e 2të të vonesës : kujtesë me shkrim, Frz 8.- nga 18 vjeç e sipër.

javën e 3të të vonesës : shuma që duhet të paguhet Frz 12.- nga 18 vjeç e sipër.

javën e 4të të vonesës : shuma që duhet të paguhet Frz 16.- nga 18 vjeç e sipër.

javën e 5të të vonesës : kujtesë me shkrim, shuma që duhet të paguhet Frz 24.- nga 18 vjeç e sipër.

javën e 6të të vonesës : shuma që duhet të paguhet, Frz 32.- nga 18 vjeç e sipër.

javën e 7të të vonesës : shuma që duhet të paguhet Frz 40.- nga 18 vjeç e sipër.

javën e 8të të vonesës : kujtesa e fundit me shkrim nga ana jonë, shuma që duhet të paguhet Frz 56.- nga 18 vjeç e sipër.

javën e 9të të vonesës : shuma që duhet të paguhet, Frz 72.- nga 18 vjeç e sipër.

javën e 10të të vonesës : fatura që duhet të paguhet, Frz 88.- nga 18 vjeç e sipër.

### Humbje ose dëmtime

Nëse ju e keni humbur ose dëmtuar një dokument, ju duhet të paguani çmimin e blerjes dhe shpenzimet shtesë, nga 18 vjeç e sipër :

Çmimi i dokumentit, më pak se Frz 10.- : Frz 1.-

Çmimi i dokumentit nga Frz 10.- në 29.- : Frz 4.-

Çmimi i dokumentit nga Frz 30.- në 59.- : Frz 8.-

Çmimi i dokumentit nga Frz 60.- në 89.- : Frz 12.-

Çmimi i dokumentit nga Frz 90.- e sipër : Frz 20.-

Gazeta : shuma që duhet të paguhet, Frz 5.- nga 18 vjeç e sipër.

Revista : shuma që duhet të paguhet, Frz 10.- nga 18 vjeç e sipër.

Ju e keni humbur një dokument dhe tashmë i keni paguar shpenzimet ?

Pastaj e gjeni dokumentin në gjendje të mirë ?

Atëherë mund ta sillni në bibliotekë, brenda 4 muajve pas pagesës.

- paraqisni fletë-arkëtimin e pagesës
- biblioteka jua kthen një pjesë të të hollave

Nëse e sillni brenda 30 ditëve, biblioteka jua kthen të hollat, por mban Frz 10.-

Pas 30 ditësh, ajo mban Frz 15.-

## Shpenzime të tjera

Për personat nën 18 vjeç, vetëm çmimi i dokumentit të humbur ose të dëmtuar do të kërkohet.

Nëse duhet ta zëvendësojmë kartën tuaj : shuma që duhet të paguhet, Frz 10.- nga 18 vjeç e sipër

Nëse duhet të kërkohet adresën tuaj, sepse nuk e keni njoftuar : shuma që duhet të paguhet, Frz 8.- nga 18 vjeç e sipër

Nëse nuk keni ardhur të tërhiqni dokumentin e rezervuar : shuma që duhet të paguhet, Frz 2.- nga 18 vjeç e sipër

Nëse duhet të zëvendësojmë një etiketë të dëmtuar ose të humbur : shuma që duhet të paguhet, Frz 6.- nga 18 vjeç e sipër

Nëse duhet të zëvendësojmë kutinë ose xhepin e një CD-je : shuma që duhet të paguhet, Frz 2.- nga 18 vjeç e sipër

Pas 10 javësh vonesë të dokumentit të parë, ne duhet të bëjmë një faturë dhe t'jua dërgojmë : shuma që duhet të paguhet, Frz 50.- nga 18 vjeç e sipër

Dhe shpenzimet për çdo dokument shtesë : shuma që duhet të paguhet, Frz 10.- nga 18 vjeç e sipër

Për çdo shpenzim tjetër, ne duhet të bëjmë një faturë dhe t'jua dërgojmë : shuma që duhet të paguhet, Frz 30.- nga 18 vjeç e sipër

Nëse keni humbur ose keni dëmtuar një aparat (tabletë apo lexues) : shuma që duhet të paguhet, Frz çmimi i aparatit të ri (e shumta Frz 600.-)

Nëse keni humbur ose dëmtuar një xhep tablete : shuma që duhet të paguhet, Frz 50.-

## Siti i bibliotekave

[bavl.lausanne.ch](http://bavl.lausanne.ch)

FB [Lire à Lausanne](#)

YouTube [Lire à Lausanne](#)



Le site Internet des bibliothèques :  
[bavl.lausanne.ch](http://bavl.lausanne.ch)

**FB + YouTube**

Lire à Lausanne

